**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**Ac.nr.5202/17**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, kolegji në përbërje nga gjyqtari Valon Totaj - kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.M. nga fshati ... komuna e Skenderajt, të cilin e përfaqëson i autorizuati i tij av.SH.I. nga Skenderaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve (K.S.) "E...", me seli në Prishtinë rruga "..., për shkak të kompensimit dëmit material, duke vendosur sipas ankesës së të paditures, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj C.nr.222/2016, të datës 18.09.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 31.08.2020, mori këtë:

# A K T GJ Y K I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve (K.S.) "E...", me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj C.nr.222/2016, i datës 18.09.2017, **VËRTETOHET.**

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me pikën I të aktgjykimit të ankimuar C.nr.222/2016, të datës 18.09.2017, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit M.M.. Me pikën II të aktgjykimit është detyruar e paditura K.S. "E...", me seli në Prishtinë që paditësit M.M. në emër të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e trafikut rrugor i cili ka ndodhur me datën 13.03.2016, në veturën e tij Volkswagen me targa regjistrimi ..., t'ia paguaj shumën prej 1825 euro (njëmijë e tetëqind e njëzet e pesë euro), me kamat ligjore 8% nga dita e gjykimit (datë 18.09.2017), e deri në pagesën definitive në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Me pikën III të aktgjykimit, është obliguar e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguaj shumën prej 313 euro, në afatin prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të

gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë duke aprovuar këtë ankesë si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën të kthej në rigjykim konform dispozitave ligjore të nenin 195 shkronja (c) e LPK apo të njëjtin ta ndryshojë ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëloj duke u bazuar në nenin 195.1 shkronja e) të LPK.

Paditësi ka ushtruar përgjigje në ankesë duke propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta refuzojë ankesën e të paditurës në tërësi dhe të vërtetoj aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj C.nr.222/2016, të datës 18.09.2017.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore në ankesë lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- ankesa e të paditurës, është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datën 23.06.2016, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit e dëmit material, me arsye sikurse në padi.

Duke vendosur sipas padisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të propozuara, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.222/2016, të datës 18.09.2017, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në dispozitiv të tij. Në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se nga provat e administruara në këtë çështje kontestimore, është provuar bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit. Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 159.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), ndërsa për lartesin e shpërblimit të dëmit është bazuar në nenin 173.2 te LMD. Lidhur me kamatën e njëjta ka vendosur në kuptim të neneve 378 dhe 382 të LMD, kurse në raport me shpenzimet procedurale, gjykata ka vendosur sipas nenit 452.2 të LPK.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurit se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, rrjedhimisht edhe i përmbarueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivit me arsyetimin.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të padituri t për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese të provave të administruara, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë edhe sa i përket dëmit që i është shkaktuar paditësit për shkak të aksidentit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës së eksperteve ing.S.B. - ekspert i makinerisë & komunikacionit si dhe ing.Y.K. - ekspert i komunikacionit, i pranon si të tilla edhe Gjykata e Apelit, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo – juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar në shumën sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e njëjta është adekuate, e krejt kjo duke marr parasysh dëmin material që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj të dëmtuarit - këtu paditësit, satisfaksion që ai me këto mjete t'i riparoj në një masë nevojat e tij materiale që përndryshe në asnjë rrethanë nuk paraqesin kompensim absolut të dëmit.

Edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje më veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve dhe në pajtim me dispozita e LPK.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d), në lidhje me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**
**Ac.nr.5202/17, me datën 31.08.2020**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**
**Valon Totaj**